



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
Ministarstvo Industrije, Preduzetništva i Trgovine
Ministry of Industry, Entrepreneurship and Trade

Departamenti i Industrisë - Divizioni për Politika Industriale

SEKTORI C

INDUSTRIA PËRPUNUESE

R
A
P
O
R
T

2
0
2
3



Përmbajtja

Lista e shkurtesave	4
Lista e tabelave.....	5
Lista e figurave.....	6
Hyrje.....	7
Metodologjia.....	8
ANALIZA EKONOMIKE	9
Bruto produkti vendor	9
Pjesëmarrja e vlerës së shtuar në BPV.....	11
Vlera e shtuar për kokë banori.....	11
Pjesëmarrja e vlerës së shtuar në BPV sipas sektorëve	12
Investimet e huaja direkte	13
Investimet e huaja direkte sipas aktivitetit ekonomik.....	13
Investimet e huaja direkte sipas shteteve	14
Tregu financiar.....	15
Kreditë e brendshme nga bankat për sektorin privat (% e BPV-së)	15
Bilanci tregtar	16
Pjesëmarrja e eksporteve në (% e BPV)	16
Eksportet dhe importet.....	17
Diversiteti gjeografik i eksporteve dhe importeve	20
ANALIZA SOCIALE	21
Fuqia punëtore	21
Pjesëmarrja e sektorit C në punësim.. ..	21
Kontributi i nën sektorëve në punësimin e përgjithshëm të Sektorit-C.....	23
Gratë të punësuar në sektorin C	23
Elasticiteti i punësimit	24
Pagat në prodhim.....	25
Intensiteti relativ i pagave në industrializim	26
Totali i pagave në sektorin-C, në raport me VShP.....	27
ANALIZA MJEDISORE	28
Eficienca e energjisë në sektorin e prodhimit	28
Intensiteti i energjisë në prodhim.....	28
Emetimet e CO2	29

Intesiteti i CO2 për vlerën e shtuar në Prodhim.....	30
Industria e gjelbër dhe qarkore.....	30
Mbeturinat e trajtuara (ricikluara) sipas viteve dhe llojit.....	31
Përmbledhje e indikatorëve.....	32
Konkluzionet.....	33
Referencat.....	34

Lista e shkurtesave

ASK	-	Agjencia e Statistikave të Kosovës
ATK	-	Administrata Tatimore e Kosovës
BE	-	Bashkimi Evropian
BKK	-	Buxheti i Konsoliduar i Kosovës
BPV	-	Bruto Prodhimi Vendor
BQK	-	Banka Qendrore e Kosovës
DI	-	Departamenti i Industrisë
DK	-	Dogana e Kosovës
DPI	-	Divizioni për Zhvillimin e Politikave Industriale
IHD	-	Investimet e Huaja Direkte
KTD	-	Korporata Tjera Depozituese
MINT	-	Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
NMVID	-	Norma Mesatare Vjetore e Interesit në Depozita
VSHP	-	Vlera e Shtuar e Prodhimit
WITS	-	Zgjidhja e Tregtisë së Integruar Botërore
WDI	-	Treguesit e Zhvillimit Botëror
KTOE	-	Kilo ton për njësi ekuivalente të naftës

Lista e tabelave

Tabela 1	Bruto Produkti Vendor sipas sektorëve ekonomik.....	10
Tabela 2	IHD sipas sektorëve ekonomike, 2016 – 2023.....	13
Tabela 3	IHD sipas vendeve të origjinës, 2015 – 2023.....	14
Tabela 4	Normat efektive të interesit në kredi të KTD-ve.....	15
Tabela 5	Sektori-C, eksporti dhe importi me vendet tjera.....	17
Tabela 6	Sektori C, Numri i ndërmarrjeve dhe të punësuarve.....	22
Tabela 7	Elasticiteti i punësimit krahasuar me vendet tjera.....	25
Tabela 8	Pagat.....	26

Lista e figurave

Figura 1	Performanca e BPV-së/ kokë banori e Kosovës krahasuar me vendet e rajonit.....	9
Figura 2	Vlera e shtuar e sektorit prodhues pjesëmarrja në BPV.....	11
Figura 3	Vlera e Shtuar e Prodhimit për kokë banori në BPV, Kosova krahasuar me vendet tjera...	12
Figura 4	Vlera e shtuar në BPV sipas sektorëve.....	12
Figura 5	Bilanci tregtar i Kosovës.....	16
Figura 6	Pjesëmarrja e eksporteve totale në (% e BPV).....	16
Figura 7	Diversifikimi gjeografik i Eksportit dhe Importit.....	20
Figura 8	Kontributi i nën sektorëve në punësimin e Sektorit-C, në %.....	23
Figura 9	Punësimi gjithëpërfshirës në % (sipas gjinisë).....	24
Figura 10	Intensiteti relativ i pagave të industrisë.....	26
Figura 11	Fatura e pagave në raport me vlerën e shtuar, VSHP shprehur në %.....	27
Figura 12	Efiçienca e energjisë në sektorin e prodhimit.....	28
Figura 13	Intensiteti i energjisë.....	29
Figura 14	Emetimet e CO2, për 1 milion euro në VSHP.....	29
Figura 15	Intensiteti i CO2 për 1 milion euro në VSHP të gjeneruar.....	30
Figura 16	Mbeturinat e trajtuara (recikluara sipas llojit).....	30

Hyrje

Zhvillimi industrial në Kosovë ka qenë një proces dinamik dhe sfidues, me ndihmën e ndryshimeve politike dhe ekonomike që kanë ndodhur në vitet e fundit.

Pas përfundimit të luftës në vitin 1999 dhe shpalljes së pavarësisë në vitin 2008, Kosova ka kaluar nëpër një periudhë tranzicioni të gjatë. Strukturat e mëparshme industriale janë dëmtuar dhe duhej të ndihmoheshin për të rifilluar dhe për të zhvilluar sektorin industrial.

Transformimi gradual i industrisë të Kosovës në një ekonomi me të ardhura më të larta për përmirësimin e mirëqenies socio-ekonomike të qytetarëve të Kosovës.

Ndoshta më shumë se sektorët e tjerë, prodhimi ka një potencial më të lartë për të krijuar produktivitet të konsiderueshëm dhe fitime shtesë në vlerë duke tërhequr teknologjitë e reja dhe inovacionin. Zhvillimi industrial mund të ketë gjithashtu implikime të shumta pozitive zhvillimore përtej sektorit të prodhimit, për shkak të lidhjeve të ndryshme me sektorët e tjerë të ekonomisë, zhvillimi industrial mund të stimulojë rritjen dhe zhvillimin në sektorë të tillë si bujqësia dhe minierat në Kosovë dhe në industritë e shërbimeve përkatëse.

Për të pasur një pasqyrë të detajuar të gjendjes apo trendëve të zhvillimit të industrisë, hartuesit e Politikave Industriale në kuadër të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, bazuar në të dhënat e përpunuara statistikore kanë përgatitur raportin vjetor të industrisë përpunuese 2023, për analizën e performancës të sektorit-C, duke analizuar tre dimensionet kryesore: dimensionin ekonomik, social dhe mjedisor.

Qëllimi i hartimit të Raportit Vjetor është paraqitja e trendëve kryesore të zhvillimit të ekonomisë së Kosovës, për vitet 2021-2023, me theks të veçantë në degët kryesore industriale, gjatë vitit 2023, por edhe një analizë krahasuese me vendet e rajonit, si dhe trendi i zhvillimeve në sektorët e industrisë përpunuese

Të dhënat e analizuara, që janë paraqitur në këtë raport, mund t'iu shërbejë institucioneve, akademikëve, hartuesve të politikave, bizneseve operuese, (të tanishme dhe atyre me potencial në sektorin privat), investitorëve, donatorëve, hulumtuesve, etj. Raporti për Sektorin-C (industrinë përpunuese) ofron një pasqyrë më të hollësishme rreth trendëve kryesore me ndikim në industrinë e vendit si dhe lehtëson punën e të gjithë akterëve përkatës në hartimin e politikave zhvillimore më të efektshme, bazuar në indikatorë të matshëm.

Në mungesë të statistikave për vitet 2022-2023, për disa tregues të analizuar në këtë raport nga institucionet zyrtare për të dhënat statistikore si; ASK-ë, UNCTAD, WITTs, ILO, etj. Janë përdorur të dhëna të vitit 2021, ngase viti bazë i fundit nga SIZHMB-2030, ishte viti 2020.

Metodologjia

Raporti është hartuar duke përdorur metodat kërkimore të raporteve të ndryshme hulumtuese si dhe të dhënave sasiore dhe cilësore të pranuar nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, Banka Qendrore e Kosovës, treguesit e bankës botërore dhe institucionet tjera relevante.

Të dhënat sasiore dhe cilësore, janë përpunuar dhe analizuar nga stafi i MINT-it konkretisht nga përpunuesit e të dhënave statistikore dhe hartuesit e politikave industriale në Departamentin e Industrisë.

Me qëllim të ofrimit të informatave të sakta të paraqitura në format tabelore dhe figurative janë përdorur metodat e kombinimit dhe krahasimit për të dhënat e prezantuara.

Të dhënat statistikore janë përpunuar në pjesën e përgjithshme për Industrinë përpunuese të Sektorit-C, vlerat e përgjithshme që përfshinë kodet 10-33, duke krahasuar me vendet e Ballkanit Perëndimor (BP6). Përshkrimi i nën sektorëve, në këtë Raport është radhitur sipas kodeve, ashtu siç janë të radhitura në NACRev2.

Të dhënat për nën sektorët për eksportin dhe importin, janë përpunuar sipas kodeve doganore, kapitujve, ndërsa të dhënat për nën aktivitetet për ndërmarrjet, punësimin dhe qarkullimin në Kosovë janë paraqitur sipas kodit katër shifror NACRev2.

Nga të dhënat statistikore të përpunuara janë hartuar analiza për dimensionet: ekonomik, social, dhe mjedisor.

Pas analizave të paraqitura lidhur me të dhënat e përgjithshme dhe trendët për industrinë përpunuese - Sektori-C, në këtë raport janë ofruar konkluzionet që kanë të bëjnë me gjendjen dhe trendët e prodhimit në industrinë përpunuese në Kosovë .

Për të gjitha të dhënat që janë përdorur në Raportin Analitik për industrinë përpunuese janë shënuar thirrjet apo burimi i informatave.

ANALIZA EKONOMIKE

Bruto produkti vendor


Bruto Produkti Vendor (BPV) është treguesi më i rëndësishëm ekonomik i llogarive kombëtare, i cili paraqet performancë ekonomike të një shteti në një periudhë të caktuar kohore.

Sipas statistikave të Llogarive Kombëtare, rritja reale e BPV në vitin 2023 krahasuar me vitin 2022, ishte 3.3%.

Sipas të dhënave të “World Development Indicators”, në raport me Vendet e Ballkanit Perëndimor dhe Statistikave të Llogarive Kombëtare të Kosovës (2008-2022), Kosova paraqet performancën më të ulët ekonomike të përgjithshme në BPV / kokë banori prej € 5,038 për vitin 2023, që do të thotë se është nën mesataren e BP6 sa është € 6,145.

Pavarësisht mungesës, duke filluar nga një bazë e ulët, Kosova ishte duke u rritur me një ritëm më të shpejtë se sa homologët e saj rajonalë: shkalla e rritjes së BPV-së/kokë banori e Kosovës ishte prej 5.9% gjatë periudhës 2011-2023 ku tejkaloi rajonin me (0.8%), me përjashtim të Bosnjës e Hercegovinës e cila kishte rritje për 6.1%, ndërsa mesatarja e BP6 ishte 5.4%. Megjithatë, shkalla ekzistuese e rritjes duhet të përshpejtohet për të siguruar arritjen më të shpejtë të homologëve të saj rajonalë.

Figura 1: Performanca e BPV-së/ kokë banori e Kosovës krahasuar me vendet e rajonit



Burimi: World Development Indicators

Për të analizuar BPB sipas aktivitetit ekonomik, në tabelën 1. është pasqyruar se si kontribuojnë sektorët e ndryshëm në ekonominë e vendit.

Tabela 1. Bruto Produkti Vendor sipas aktiviteteve ekonomike, me çmime aktuale (në %)

Nace Rev.2	Aktivitetet ekonomike	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022	Viti 2023
A	Bujqësia, gjuetia , pylltaria dhe peshkimi	6.5	7.2	7.4	6.9	7.4	7.8
B	Industria nxjerrëse	2.2	2.0	2.0	1.9	1.5	1.7
C	Industria përpunuese	13.1	12.9	13.4	12.9	13.2	12.8
D	Furnizimi me energji elektrike, me gaz	3.5	3.4	3.9	3.6	3.8	3.1
E	Furnizimi me ujë	0.7	0.7	0.6	0.6	0.6	0.6
F	Ndërtimtaria	8.4	8.2	7.7	8.5	8.5	8.2
G	Tregtia me shumicë dhe pakicë; riparimi i automjeteve dhe motoçikletave	12.5	12.8	12.8	13.6	14.3	14.2
H	Transporti dhe magazinimi	4.5	4.4	3.9	4.3	4.4	4.5
I	Hotelet dhe restorantet	1.9	2.1	1.6	2.1	2.1	2.1
J	Informimi dhe komunikimi	1.9	1.9	2.0	1.9	2.0	2.0
K	Aktivitetet financiare dhe te sigurimit	3.6	3.9	4.1	3.7	3.9	4.3
L	Afarizmi me pasuri të patundshme	7.1	7.0	7.3	6.4	6.1	5.9
M	Aktivitetet profesional, shkencore dhe teknike	1.5	1.4	1.6	1.4	1.4	1.4
N	Aktivitetet administrative dhe mbështetëse	0.7	0.7	0.7	0.7	0.7	0.7
O	Administrimi publik dhe i mbrojtjes; sigurimi i detyrueshëm social	5.8	5.9	6.6	5.5	5.0	5.0
P	Edukimi	3.8	3.7	3.8	3.4	3.1	3.2
Q	Shëndetësia dhe aktivitetet e punës sociale	2.2	2.2	2.7	2.3	2.1	2.2
R	Art, zbavitje dhe rekreacion	0.4	0.2	0.2	0.2	0.2	0.2
S	Shërbime tjera	0.4	0.4	0.4	0.3	0.3	0.3
T	Aktivitetet e ekonomive familjare si punëdhënës; Mallra dhe shërbimet e pa diferencuara që prodhojnë aktivitetet e familjeve për përdorim vetanë	-	-	-	-	-	-
	BVSH me çmime bazë	80.6	80.8	82.6	80.2	80.4	80.1
	Tatimet në produkte	19.4	19.2	17.4	19.8	19.6	19.9
	Subvencionet në produkte	-	-	-	-	-	-
	Bruto Produkti Vendor	100	100	100	100	100	100

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës / <https://askdata.rks-gov.net/> Qasur më 02.07.2024

Sipas tabelës nr.1, në vitin 2023, tregtia me shumicë dhe pakicë, riparimi i automjeteve dhe motoçikletave është aktiviteti ekonomik i cili kontribuon më së shumti në BPV, me 14.2% në totalin e vlerës së BPV, pastaj renditet Industria përpunuese me 12.8% e cila krahasuar me vitin 2022 ka rënie në pjesëmarrjen e BPV për 0.4%.

Spektori-C, Industria përpunuese në BPV merr pjesë me 12.8 %.


Nga gjithsej 20 aktivitetet ekonomike të pasqyruara në tabelë, rritje kanë shënuar 6 aktivitete. Ndërsa në vitin 2022, rritje kishin 7 aktivitete, ndër të cilat rritjen më të lartë në vitin 2023 e ka shënuar aktiviteti Bujqësia, gjuetia, pylltaria dhe peshkimi dhe aktiviteti financiar dhe të sigurimit me nga 0.4%.

Pjesëmarrja e vlerës së shtuar në BPV

Sistemi i Llogarive Kombëtare të Kombeve të Bashkuara kërkon që vlera e shtuar të vlerësohet ose me çmimet bazë (duke përjashtuar taksat neto mbi produktet) ose me çmimet e prodhimit (përfshirë taksat neto mbi produktet e paguara nga prodhuesit, por duke përjashtuar shitjet ose taksat mbi vlerën e shtuar). Të dy vlerësimet përjashtojnë tarifën e transportit që faturohen veçmas nga prodhuesit. BPV-ja totale matet me çmimet e blerësve. Vlera e shtuar nga industria zakonisht matet me çmimet bazë.

Në vitin 2023, industrializimi i Kosovës, i matur me pjesëmarrjen e VShP në BPV, është (12.77%) e tejkalon mesataren e BP6 (10.25%), me përjashtim të Bosnjës e Hercegovinës me (13.05%).

Figura 2. Vlera e shtuar e sektorit prodhues në BPV¹



Burimi: World Development Indicators


Vlera e Shtuar për kokë banori

Vlera e shtuar për kokë banori tregon bazën e nivelit të industrializimit të një vendi të përshtatur për madhësinë e ekonomisë. Një nga përdorimet statistikore të VShP për kokë banori, është klasifikimi i grupeve të vendeve sipas fazës së zhvillimit industrial.

Kapaciteti prodhues i një vendi matet me vlerën e shtuar të gjeneruar në sektorin e prodhimit për kokë banori. Sipas kësaj, në vitin 2023 Kosova kishte 647.3€/kokë banori, mbi mesataren e BP6 prej 588.82 €/kokë banori, më ulët se Serbia e cila VSHP e kishte 968.1€/kokë banori dhe Bosnjën e Hercegovinën me 669.7 €/kokë banori.

¹ Të dhënat për vitin 2023 për Serbinë dhe Malin e ZI nuk janë publikuar, andaj janë marrë të dhënat nga viti 2022.

Figura 3: Vlera e Shtuar e prodhimit për kokë banori në BPV, Kosova krahasuar me vendet tjera


Burimi: WDI, (përpunuar nga stafi i DI/DPI-së)²

Pjesëmarrja e vlerës së shtuar në BPV sipas sektorëve

Kosova ndërmjet viteve 2011 dhe 2023, ka shfaqur pak ndryshime strukturore në përbërjen e ekonomisë së saj. Për ekonominë e përgjithshme rëndësia e prodhimit është relativisht e kufizuar. Pjesa e vlerës së shtuar e prodhimit (VShP), si pjesë e BPV -së, mbeti e qëndrueshme, nuk ka ndonjë ndryshim mes vitit 2022 dhe 2023.

Pesha e vlerës së shtuar në shërbime përbënte mesatarisht 45%, ndërsa miniera duke e përfshi ndërtimtarinë, përbënte mesatarisht 14% të BPV-së gjatë së njëjtës periudhë.

Figura 4. Vlera e shtuar në BPV sipas sektorëve



Burimi: WDI, përpunuar nga stafi i DI/DPI

² Të dhënat e VShP për vitin 2023 për Serbinë dhe Malin e ZI nuk janë publikuar, andaj janë marrë të dhënat nga viti 2022.

Investimet e huaja direkte

Investimet e huaja direkte ndikojnë në rritjen e mundësive për integrim ekonomik duke krijuar lidhje të qëndrueshme dhe afatgjata në tregjet ndërkombëtare.

Kompanitë e mëdha botërore transferojnë kapitalin e tyre në ato vende që ofrojnë kushte më të mira në investime. Përveç taksave më të ulëta, fuqisë punëtore më të lirë dhe të kualifikuar, kompanitë janë të interesuara edhe për sundimin e rendit dhe ligjit në vendin e investimeve, por edhe për sigurimin e investimeve nga vendi përfitues.

Pjesëmarrja IHD-ve të prodhimit në totalin e IHD-ve për vitin 2023 ishte 1.56%.

Investimet e huaja direkte sipas aktivitetit ekonomik

Të dhënat e Bankës Qendrore të Kosovës tregojnë se në vitin 2023, hyrjet neto të IHD-ve në sektorin e prodhimit ishin 13.2 milion euro, deri sa në vitin 2022, 14.3 milion euro.

Sipas raportit të BQK-së, sektori i patundshmërisë vazhdon të prijë në pjesëmarrje me 60.6% të gjithë IHD-ve hyrëse, që si sektor megjithatë, shënoi rënie të lehtë prej 3.4 % krahasuar me vitin paraprak.

Këtë vit është vërejtur rritje e lehtë e IHD-ve hyrëse në sektorin financiar përfshirë sigurimet dhe furnizimin me energji elektrike.

Tabela 2. IHD sipas sektorëve ekonomike, 2016 – 2023 (në milionë euro)

Sektorët	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023
Bujqësia, pylltari dhe peshkatari	1.3	(1.3)	0.1	1.5	2.8	1.1	0.7	0.7
Xehetaria dhe guroret	(19.1)	(4.9)	(2.7)	(6.9)	29.1	1.4	52.4	36.7
Prodhimi	4.2	6.1	(17.7)	14.2	(4.6)	-0.4	14.3	13.2
Furnizimi me energji, gaz, avull dhe me ajër të kondicionuar	(0.4)	(0.8)	12.1	13.5	30	(38.8)	44.3	62.5
Furnizimi me ujë, kanalizim, menaxhim mbeturinash	0.6	0.0	2.5	(0.6)	0.2	(0.5)	(0.2)	0.2
Ndërtimi	28.1	5.1	24.8	(17.1)	11.4	16.7	26.7	11.9
Tregti me shumicë dhe pakicë, riparim i mjeteve motorike, motoçikletave	14.0	9.0	19.6	(6.7)	(8.1)	(4.0)	15.1	17.2
Transport dhe ruajtje	0.9	(0.8)	(0.2)	(6.2)	(16.0)	4.3	(4.1)	-12.0
Akomodim dhe aktivitete të shërbimeve me ushqim	0.8	1.1	1.8	1.4	1.1	0.7	(4.1)	0.2
Informacioni dhe Komunikimi	(4.2)	(3.8)	(9.6)	2.3	1.6	17.3	14.0	12.9
Aktivitetet financiare dhe të sigurimit	19.0	55.2	15.5	13.9	85.1	24.6	53.9	175.6
Aktivitetet të patundshmërive	139.7	154.7	205.2	223.8	201.1	384.0	523.7	511.2
Aktivitetet profesionale shkencore dhe teknike	5.8	5.7	5.2	3.4	3.6	5.7	10.7	7.5
Aktivitetet administrative dhe mbështetëse	21.9	23.7	4.7	3.7	0.8	1.4	10.7	-1.0
Administratë publike dhe mbrojtje; siguri sociale dhe detyrueshmëri	1.9	1.3	0.9	1.7	1.1	1.1	1.5	1.5
Arsim	0.8	0.7	0.7	1.3	1.3	1.8	2.2	1.8
Shëndetësi njerëzor dhe aktivitete të punës sociale	1.3	(1.0)	(0.4)	0.6	0.3	2.7	1.2	0.7
Art, zbavitje dhe rekreacion	0.1	0.0	0.5	0.5	(0.1)	0.1	0.6	0.6
Aktivitetet të shërbimeve tjera	3.9	3.7	7.2	2.8	1.7	(1.2)	1.2	-1.1
Të pa klasifikuar	(0.3)	1.5	2.0	7.6	3.0	2.6	12.6	3.8

Burimi: Banka Qendrore e Kosovës / <https://bqk-kos.org/statistikat/serite-kohore/> qasur më 05.07.2023

Nga te dhënat e tabelës nr.2, IHD-të, sipas aktivitetit ekonomik, sektori financiar dhe i sigurimit ka 175.6 milion euro investime, me një rritje prej 121.7 milion euro, krahasuar me vitin 2022. Sektori Furnizimi me energji, gaz, avull dhe me ajër të kondicionuar ka shënuar rritje në vlerë prej 18.2 milion euro investime, krahasuar me vitin 2022, respektivisht nga 44.3 milion euro sa ka qenë në 2022, është rritur në 62.5 milion euro në vitin 2023. Sektori Xehetaria dhe gurorët ka shënuar rënie në vlerë të investimit prej 36.7 milion euro krahasuar me vitin 2022.

Shikuar nga vlera investuese, sektori i cili ka shënuar vlerën më të lartë investive është sektori “Aktivitete të patundshmërive” me 511.2 milion euro.

Investimet e huaja direkte sipas shteteve

Investimet e Huaja Direkte (IHD) sipas shteteve, gjatë viteve 2015-2023, kanë një trend të qëndrueshëm të ngritjes së vlerës së IHD-ve. Vlera e përgjithshme e IHD-ve për vitin 2023 ishte 844.3 milion euro, deri sa në vitin 2022 ishte 777.9 milion euro, që do të thotë se ka pasur rritje për 8.54%.

Tabela 3. IHD sipas vendeve të origjinës, 2015 – 2023 (në milion euro)

Shtetet		Vitet								
		2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023
AT	Austria	33.5	9.9	20.3	11.2	11.9	27.6	22.9	44.7	63.4
DE	Gjermania	45.3	25.7	55.9	60.3	70.2	67.5	121.9	194.2	190.4
SI	Sllovenia	5.6	-4.5	1.2	-8.7	6.1	8.1	5.8	21.2	34.0
GB	Britania e Madhe	26.6	13.6	27.0	57.4	0.8	21.4	0.1	-3.4	48.1
CH	Zvicra	72.9	61.8	50.6	71.0	61.9	64.1	99.2	155.2	175.8
TR	Turqia	55.4	42.7	29.5	12.2	-31.9	14.6	-38	39.0	57.5
NL	Holanda	-36.4	-23.1	-14.1	-39.7	1.9	0.1	7.6	43.7	22.4
AL	Shqipëria	40.1	28.6	2.4	22.3	15.2	39.8	50.4	79.8	64.0
LU	Luksemburgu	0.1	0.6	2.1	1.9	1.3	-2.7	-3.6	1.8	1.3
RS	Serbia	0.8	-0.6	-1.4	0.4	0.4	6.0	5.0	-0.7	1.4
US	Shtetet e Bashkuara	25.0	23.0	20.3	35.5	22.8	29.6	63.7	93.0	67.0
FR	Franca	3.2	2.8	3.6	5.6	3.4	3.7	10.2	9.9	10.6
BG	Bullgaria	1.6	0.4	0.5	2.1	1.0	0.9	-0.8	1.4	0.6
MK	Maqedonia	0.1	3.2	-1.0	1.3	2.0	1.8	1.8	2.0	4.8
BA	Bosnja dhe Hercegovina	0.8	1.2	0.7	0.4	0.1	0.1	0.4	0.3	0.7
HR	Kroacia	0.1	-1.7	0.7	-1.0	0.9	-1.2	3.0	1.5	9.7
MT	Malta	0.1	0.1	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.8	1.7
CY	Qipro	0.1	0.4	0.8	1.3	2.9	0.9	0.9	1.7	2.1
SK	Sllovakia	0.1	0.8	0.1	0.5	1.4	0.3	0.3	0.2	0.1
CA	Kanadaja	1.1	2.5	3.0	3.2	5.3	4.7	8.8	17.8	13.3
CZ	Çekia	1.3	0.2	0.7	1.5	0.4	0.5	1.0	0.7	2.0
AE	Emiratet e Bashkuara Arabe	1.4	3.6	13.4	-2.5	3.8	2.8	0.6	4.5	-0.7
NO	Norvegjia	2.9	3.4	3.5	5.1	4.9	3.2	7.7	7.0	6.3
KW	Kuvajti	0.0	0.2	0.0	-1.1	0.7	0.1	-0.5	-0.1	0.3
ES	Sopanja	-0.8	0.2	2.5	0.3	0.7	0.0	0.3	0.1	0.9
EG	Egjipti	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
IT	Italia	5.7	1.9	7.0	2.7	7.9	3.5	8.5	10.4	11.8
GR	Greqia	-0.2	-0.4	-1.2	-0.3	0.1	-0.1	-1.1	-0.1	-0.3
HU	Hungaria	0.3	0.6	0.4	0.1	19.1	26.1	3.6	14.3	19.1
Tjera	Tjera	22.1	22.8	26.9	29.1	39.6	22.3	40.7	37.0	36.0
Gjithsej		308.8	220.0	255.4	272.1	254.8	345.7	420.4	777.9	844.3

Burimi: Banka Qendrore e Kosovës, <https://bqk-kos.org/statistikat/serite-kohore/qasur> më 09.07.2024

Sipas raportit të BQK-së, në kuadër të llogarisë financiare, IHD-të hyrëse në vitin 2023 shënuan rritje vjetore prej 15.3% dhe arritën vlerën prej 844.3 milionë euro (8.7% e BPV-së).

Tri shtetet kryesore prej nga vijnë IHD-të hyrëse janë Gjermania me 22.6% të gjithsej IHD-ve hyrëse, Zvicra me 20.8%, dhe ShBA-të me 7.9%.

Tabela nr.3. pasqyron se ndër vendet me investime më të larta të IHD-ve, për vitin 2023, është Gjermania, me investime prej 190.4 milion euro, me një rënie prej 1.96% krahasuar me vitin 2022. Zvicra për nga investimet radhitet e dyta, me 175.8 milion euro, me rritje për 13.27%, Turqia me 57.5 milion euro, me rritje për 47.44% etj.

Tregu financiar

Sa i përket normave efektive të interesit të korporatat tjera depozituese (KTD), marrë mesataren e normave të interesit për sektorët e pasqyruar në tabelën nr. 4, në vitin 2023, vërehet një rritje e normës së interesit në Industri për 0.8% krahasuar me vitin 2022.

Norma efektive e interesit në sektorin e industrisë është 6.8%.

Tabela 4. Normat efektive të interesit në kredi të KTD-ve

Sektorët	Norma e Interesit 2020	Norma e Interesit 2021	Norma e Interesit 2022	Norma e Interesit 2023
Kredi Konsumuese	6.8%	6.4%	6.3%	6.4%
Kredi Hipotekare	5.7%	5%	4.9%	5.3%
Bujqësore	9.3%	7.96%	8%	9.1%
Industriale	6.0%	5.9%	6%	6.8%
Shërbyese	6.0%	5.9%	6%	6.6%
Sektorët Tjerë	6.3%	6.3%	6.5%	6.9%

Burimi: Banka Qendrore e Kosovës, <https://bqk-kos.org/statistikat/serite-kohore/>

Sipas të dhënave nga tabela 4. në të gjithë sektorët vërehet rritje e normave efektive të interesit në krahasim me vitet e kaluara.


Kreditë e brendshme nga bankat për sektorin privat

Tregu financiar në Kosovë është mjaft dobët i zhvilluar për prodhuesit. Banka Botërore vlerëson se gati 70% e kompanive kosovare financojnë asetet fikse përmes burimeve të brendshme. Sipas raportit vjetor 2023 të Bankës Qendrore të Kosovës, Sektori i prodhimit në vitin 2023 shënoi rritje (neto) dukshëm më të ngadalësuar vjetore prej 5.9% nga 29.4% sa ishte në vitin paraprak. Në vitin e kaluar, ky sektor kishte peshën më të lartë në rritjen e gjithsejtë kreditimit për ndërmarrjet, ndikuar edhe nga mbështetja e masave subvencionuese të qeverisë në kuadër të pakos së ringjalljes ekonomike.

Bilanci tregtar

Bilanci tregtar paraqet raportin ndërmjet eksportit dhe importit për periudhën një vjeçare. Kosova, në vitin 2023, shprehur në vlera financiare, eksportoiti 820 milionë euro, ndërsa importoi 5.7 miliardë euro. Raporti mes eksportit dhe importit është 12.6% dhe 87%, ndërsa mbulueshmëria e importit me eksport për vitin 2023 është 14.4%.

Figura 5: Bilanci tregtar i Kosovës në (miliard Euro)




Burimi: ASK-Statistikat e Tregtisë së Jashtme (STJ), dhe Dogana e Kosovës, Qershor 2023 (përpunuar nga stafi i DI/DPI-së)

Pjesëmarrja e eksporteve totale në (% e BPV)

Pjesëmarrje të lartë të eksporteve në BPV ka shënuar Maqedonia e Veriut me 73%, e dyta radhitët Serbia me 60%, derisa Kosova dhe Shqipëria radhitën të fundit me nga 40% nën nivelin e BPV-së.

Figura 6: Pjesëmarrja e eksporteve totale në (% e BPV), 2015-2023



Burimi: WDI, ASK (përpunuar nga DI/DPI-së)

Kosova në vitin 2023 ka shënuar rritje për 2% të pjesëmarrjes të eksporteve në BPV dhe Shqipëria me 3%, ndërsa rënie kishin: Maqedonia e Veriut me -2%, Bosnja e Hercegovina dhe Serbia me nga -4%, Mali Zi nuk ka pasur ndryshim, krahasuar me vitin 2022

Eksporti dhe importi i përgjithshëm

Duke u bazuar në të dhënat sipas kapitujve për eksport dhe import nga Dogana e Kosovës për vitin 2023, eksporti në totalin e saj kap vlerën e 863 milion euro, që do të thotë se kemi një rënie prej 6.3%, krahasuar me vitin 2022.

Sa i përket importit vlera e produkteve të importuara është 5.9 miliard euro, që do të thotë se kemi rritje për 5%, krahasim me vitin 2022.

Tabela 5. Eksporti dhe Importi 2022– 2023

Industria Përpunues, Sektori-C	Eksporti		Importi	
	2022	2023	2022	2023
01- Kafshë të gjalla	855,693.90	3,105,052.50	69,972,362.33	86,500,961.94
02- Mish dhe produkte prej mishi	7,828,296.97	8,361,865.41	125,305,637.94	106,183,675.38
03- Peshku dhe kafshët guaskore të nënujshme	529,828.00	541,974.00	6,352,744.27	7,342,284.58
04- Produktet bulmetore vezët e zogjve mjaltë nat	2,117,615.12	2,727,842.96	77,113,277.64	80,311,768.34
05- Produktet ushqimore me origjinë kafshe të papefshira	227,802.45	206,850.00	1,466,756.64	2,026,496.28
06- Pemët dhe bimët e tjera të gjalla, kokat e bimeve	2,143,164.95	1,249,755.50	7,762,532.63	8,800,426.59
07- Zarzavatet e ngreneshme dhe rrënjët e tuberat përkatëse	9,816,823.04	11,422,955.55	33,897,420.60	50,198,153.27
08- Frutat dhe arrat e ngrënshme, lëkurat e agrum	9,131,530.13	5,343,086.00	44,684,089.51	60,718,314.64
09- Kafe, çaj, matë dhe erëza	7,062,795.94	9,817,705.42	38,051,870.53	39,588,101.76
10- Drithërat	299,640.13	321,042.63	54,547,938.93	52,535,552.23
11- Produkte e industrisë bluajtëse maltit nises	1,304,698.88	1,927,347.30	12,013,843.41	13,599,020.66

12 Farera vajore dhe fruta oleogjene (vajore); perzierje	3,536,028.47	4,016,981.46	10,404,196.10	13,665,520.35
13 Gamëzat, rrëshirat dhe lengat dhe ekstrakte të tjera peri	1,271.87	-	411,173.28	570,070.85
14- Materialet bimore që përdoren për thurje prod	10,029.40	5,265.50	14,970.64	2,804.09
15- Vajra dhe dhjamra kafshe apo bimore dhe produ	4,525,202.99	8,171,172.18	61,084,939.19	43,767,425.75
16- Ushqimet e përgatitura prej mishit, prej peshkut	7,794,949.25	6,140,000.22	43,315,706.99	47,348,279.35
17- Sheqerna dhe ëmbëlsirat prej tij	1,261,698.17	1,552,663.18	51,081,487.83	55,213,598.17
18- Kakao dhe përgatitjet prej kakaos.	2,917,334.91	3,279,040.14	32,502,980.64	37,025,803.00
19- Përgatitjet prej drithërave, miellit, nishestes	3,446,744.50	5,462,548.08	105,410,997.85	119,481,855.04
20- Përgatitjet prej zarzavateve, frutave, arrave	11,151,924.32	14,085,662.68	40,038,299.40	49,038,987.99
21- Përgatitje të ndryshme të ngrënshme.	1,541,767.87	3,712,311.37	106,455,239.87	116,257,543.00
22- Pijet, pije alkoolike dhe uthullat.	39,040,082.89	54,115,565.24	135,762,461.35	141,998,927.32
23- Mbetjet dhe kthimet nga industritë ushqimore	2,188,742.02	2,095,098.07	33,519,660.83	32,625,004.47
24- Duhani dhe zëvendësuesit e përpunuar të duhanit	215,476.94	331,177.45	105,019,438.38	119,221,395.07
25- Kripëra, sulfuret, oksidet, gurët gelqeror, cemento	1,958,976.00	1,041,215.29	75,336,047.38	91,426,822.70
26- Minerale, skorje dhe hi	28,290,588.94	17,975,312.46	3,555,556.86	5,825,895.46
27- Lëndët djegëse minerale, vajrat minerale	73,719,370.47	33,048,628.19	966,598,773.61	765,705,140.62
28- Kimikate inorganike; komponime organike ose inorgani	341,073.19	576,309.00	7,446,684.06	7,699,543.67
29- Kimikatet organike	182,958.75	116,292.27	23,627,943.29	14,858,128.14
30- Produkte farmaceutike	1,246,269.11	1,369,484.43	126,659,944.90	116,026,981.26
31- Plehëruesit	306,381.59	258,968.32	31,018,875.21	27,138,924.09
32- Ekstraktet ngjyrosëse dhe tanikë	6,724,286.29	8,293,285.16	50,546,187.37	51,448,496.99
33- Esencat vajore dhe rezinoidet; përgatitjet e parfumerise	647,549.85	543,231.87	62,992,095.95	78,843,701.67
34- Sapuni, agjentat organike me veprim të sipërfaqshëm	9,952,164.88	12,340,990.17	51,308,162.76	60,988,325.83
35- Substanca albuminoze; amidon të modifikuar; ngjites	273,335.80	345,962.01	8,878,896.88	8,302,057.19
36- Eksplozivët; prodhimet piroteknike, shkrepsët	22.39	254.24	2,863,443.57	3,236,263.60
37- Mallrat fotografike dhe kinematografike.	150.00	67.50	1,085,008.26	949,374.42
38- Produkte të ndryshme kimike.	761,797.67	736,630.05	36,552,244.17	39,916,021.12
39- Plastikët dhe artikujt prej tyre.	122,313,716.68	114,882,278.99	340,980,135.06	301,516,265.38
40- Goma dhe artikujt prej saj	5,556,423.82	4,737,294.97	43,221,162.86	43,691,103.96
41- Lëkurat e përpunuara dhe të papërpunuara	8,875,074.24	5,140,176.18	1,398,878.99	1,996,545.94
42- Artikujt prej lekure; objekte të shalimit dhe të kalerimit;	562,205.07	1,400,032.67	11,093,822.97	15,442,625.05
43- Gëzofët dhe qimet artificiale, prodhimet prej tyre	-	2,058.17	27,250.80	51,507.73
44- Druri dhe artikujt prej druri, gypmyri i drurit	15,553,991.87	14,388,780.46	123,786,266.57	117,375,556.77
45- Tapa dhe artikujt prej tape	-	1,171.66	218,606.46	191,035.96
46- Punimet e kashtes, kallamave, xunkthit	725.90	4,882.81	192,927.74	221,474.88
47- Brumi i drurit apo i materialeve të tjera fibroze	3,856,694.40	3,384,091.00	145,403.45	131,750.93

48- Letra dhe kartoni, artikuj të brumit të letrës	6,638,472.09	7,631,971.69	77,462,058.09	73,949,349.58
49- Librat, revistat, pikturat dhe produkte të tij	717,358.10	681,264.90	8,786,244.28	8,813,978.94
50- Mendafshi	-	170.00	11,864.22	21,419.91
51- Leshi, qime kafshësh të holla apo të ashpra	20,204.10	7,797.67	157,795.43	134,482.89
52- Pambuku	316.30	10,040.48	6,855,335.92	5,799,899.08
53- Fibra të tjera tekstile vegjetale, fill letre dhe pelhure	-	18.90	42,465.16	81,579.81
54- Filamentet artificiale	180,361.29	508,942.96	10,860,336.23	14,810,667.81
55- Fibra themelore të bëra nga njerëzit	1,102,530.57	1,205,094.55	8,066,684.22	6,033,556.29
56- Mbushjet, shajaku dhe pelhura te paendura; fijey specia	123,682.98	178,289.90	16,728,263.44	16,054,152.36
57- Qilimat dhe mbuluesit e tjere tekstile te dyshemese	1,102,582.75	1,043,159.02	14,547,167.79	14,175,362.21
58- Pelhurat speciale te endura, pelhurat tekstile me xhufka	28,415.91	95,978.24	5,212,653.85	7,809,037.61
59- Pëlhurat tekstile të ngopura, të veshura, të	3,029,651.96	2,646,186.56	5,333,414.96	6,153,726.51
60- Pëlhurat e thurrura me një file apo me shumë	313,679.27	200,297.59	18,370,852.69	17,623,697.03
61- Artikujt të veshjes dhe rroba plotsuese, të thurura	3,830,186.34	7,834,475.44	68,153,383.15	85,502,893.98
62- Artikuj te veshjes dhe plotesues te tyre, te endura	15,198,590.39	20,526,194.27	93,684,504.20	119,500,745.78
63- Artikuj te tjere tekstile te gatshem; grupet e artikujve	6,627,652.60	6,908,002.45	19,116,579.78	23,272,864.67
64- Veshjet e kembeve, gjynjaket dhe te ngjashme me to,	3,141,129.68	4,097,091.01	48,675,432.58	58,590,989.30
65- Veshjet e kokës dhe pjesët prej tyre	105,451.74	57,400.26	2,210,343.60	4,084,020.21
66- Çadtrat, çadtrat e diellit, bastunet mbështetës	941,273.19	703,890.16	1,262,176.19	1,365,740.59
67- Puplat dhe artikujt e bërë nga puplat,lulet a	16,144.32	34,323.38	1,730,206.54	1,874,906.76
68- Artikuj prej guri allçie, çimentoje, asbesti	9,865,460.57	9,966,567.63	35,088,775.04	31,574,058.08
69- Produkte të qeramikes	5,969,463.58	6,716,216.95	91,065,884.07	93,300,737.74
70- Qelq dhe artikujt prej qelqi	14,586,196.76	14,415,997.73	68,893,894.96	65,590,363.50
71- Perlat natyrale apo të kultivuara, gurët e çmuar	8,984,695.71	15,106,615.51	9,913,264.43	21,784,111.61
72- Hekur dhe çelik	51,358,485.20	37,837,518.55	339,439,990.00	324,927,454.88
73- Artikuj prej hekurit dhe çeliku	92,248,415.10	94,319,958.10	101,424,042.33	104,752,893.88
74- Bakri dhe artikuj prej bakri	16,193,445.66	11,500,196.86	17,991,122.79	18,165,669.28
75 - Nikeli dhe rtikujt e tij	2,544.00	-	51,005.61	36,151.48
76- Alumin dhe artikuj prej tij	40,647,695.78	37,511,863.45	78,735,555.28	85,566,645.14
78- Plumbi dhe artikujt prej tij	4,914,367.90	3,398,034.22	41,046.29	105,408.84
79- Zinku dhe artikujt prej tij	2,766,848.31	3,169,977.90	3,962,947.42	3,757,524.01
80- Kallaji dhe artikujt prej tij	8.05	58.08	134,494.14	92,753.79
81- Metale të tjera bazë metaloqeramikat	-	163.37	632,377.05	190,538.76
82- Veglat prerese dhe veglat e punes, thikat, luget	2,183,287.52	1,906,605.01	13,717,350.81	14,972,260.61
83- Artikuj të ndryshëm prej metali bazë	2,433,024.71	2,798,458.87	37,222,369.37	38,715,813.67
84- Reaktoret berthamore, ngrohesat e ujit, makineri	15,975,888.55	17,384,782.60	393,432,057.78	433,748,689.98

85- Makineri dhe pajisje elektrike dhe pjesët e tyre	14,834,152.50	17,876,802.80	231,330,496.97	242,894,413.47
86- Lokomotivat e trenave, tramvajat, vagonët dhe	23,400.00	65,270.00	395,838.20	403,735.78
87- Mjetet e transportit të ndryshëm	11,076,031.05	11,053,768.63	409,100,359.25	589,837,503.28
88- Avionet, anijet e hapësirës dhe pjesët e tyre	-	1,910.00	154,908.47	403,931.25
89 Anije, anika dhe konstruksione lundore	17,122.71	-	55,272.99	130,421.23
90- Instrumenta dhe aparature optike, fotografike,	966,571.01	1,036,027.42	55,162,793.17	59,600,576.71
91- Orët e të gjitha llojeve dhe pjesët e tyre	2,106,384.05	1,403,970.86	9,254,597.11	7,228,458.83
92- Instrumentet muzikore; pjesët dhe plotësues të tyre	20,392.32	2,084.40	375,295.19	394,968.56
93 Armët dhe municionet; pjesët dhe aksesoret e tyre	-	-	17,919,674.88	112,937,263.94
94- Mobilitetë: Krevatet, dyshekët, mbajtëset e tyre	178,346,145.42	150,463,877.78	97,579,623.05	100,444,173.55
95- Lodrat, të domosdoshmet e lodrave dhe të sportive	420,296.54	412,270.54	21,733,187.30	23,830,368.43
96- Artikuj të ndryshëm të prodhuar	1,195,728.02	1,521,055.52	26,972,267.54	33,697,173.15
97- Veprat e artit, copat e mbledhura dhe antikat	30,296.24	49,944.57	190,312.11	368,479.36
99- Produkte të tjera	270,985.43	271,164.00	4,433,202.24	5,175,951.01
Total	20,627,916.29	863,142,111.49	5,639,396,114.11	5,917,287,078.60


Burimi: Dogana e Kosovës, përpunuar nga DI/DPI

Diversiteti gjeografik i eksporteve dhe importeve

Sipas të dhënave për eksportin e vitit 2023, rreth 60% e eksportit është realizuar në Maqedoni të Veriut, Shqipëri, SHBA, Gjermani dhe Zvicër.

Sipas të dhënave për importin në vitin 2023, rreth 60% e importit është nga Turqi, Gjermani, Kinë, Greqi, Shqipëri, Maqedoni e Veriut dhe Italia.

Figura 7: Diversiteti gjeografik i eksporteve dhe importeve (ne mil. euro)



Burimi: Dogana e Kosovës, përpunuar nga DI/DPI

Sipas figurës 7. Vërehet se diversiteti i produkteve për eksport është më i kufizuar për shkak se 60% të eksporteve janë koncentruar në 5 shtete, për derisa 60% e importeve të produkteve importohen nga 7 shtete.

Bazuar në këto të dhëna, tregu i Kosovës duhet të orientohet nga politikat tregtare më të avancuara për të eksploruar tregje të reja për eksport.

ANALIZA SOCIALE

Fuqia punëtore

Sipas ligjit të punës në Kosovë, marrëdhënia e punës mund të themelohet me çdo person prej moshës tetëmbëdhjetë (18) vjeçare. Fuqia punëtore përbëhet nga personat e punësuar dhe personat e papunë, ndërsa personat joaktivë nuk konsiderohen pjesë e fuqisë punëtore. Norma e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore është përqindja e popullsisë në moshë pune e një vendi, që angazhohet në mënyrë aktive në tregun e punës.

Sipas raportit të referuar, (Anketës së Fuqisë Punëtore të ASK-së), shkalla e pjesëmarrjes së fuqisë punëtore në vitin 2023 ishte 42.3%, që paraqet një rritje vjetore prej 3.8%.

Shkalla e punësimit ishte më e lartë të meshkujt, me 59.5%, një rritje vjetore prej 3.7% në krahasim me vitin paraprak, ndërsa, përqindja e grave të punësuar ishte 25.2%, një rritje vjetore prej 4.0% në krahasim me vitin 2022.

Statistikat zyrtare të tregut të punës tregojnë se shkalla mesatare e papunësisë në vitin 2023 ishte 10.7%, një nivel më i ulët sesa në periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

Në baza gjinore, tregu i punës në Kosovë karakterizohet nga një shkallë më e lartë e papunësisë te gratë 17.2% sesa tek meshkujt 7.9%. Sidoqoftë, edukimi ka përmirësuar perspektivat në tregun e punës në Kosovë, ku shkalla e papunësisë më e lartë është për personat pa shkollim rreth 30.4%, ndërsa më e ulëta për ata me arsimim të lartë 6.5%.

Pjesëmarrja e Sektorit-C, në punësim të përgjithshëm, numër të ndërmarrjeve dhe qarkullim vjetor

Në këtë pjesë të raportit janë analizuar të dhënat që kanë të bëjnë me numrin e ndërmarrjeve, numrin e të punësuarve dhe qarkullimin në tri vitet e fundit.

Përveç paraqitjes së të dhënave statistikore, analizat tregojnë edhe për trendët e rënies apo ngritjes të punësimit, ndërmarrjeve dhe qarkullimit vjetor në industri.

Të dhënat krahasuese në tabelën nr.10 tregojnë se, gjatë tri viteve të fundit, është shënuar rritje në të tre treguesit e analizuar si në punësim, numrin e ndërmarrjeve dhe qarkullim, ky është tregues pozitiv për ekonominë e gjithmbarshme.

Të dhënat e analizuar tregojnë se pjesëmarrja e numrit të përgjithshëm të ndërmarrjeve nga viti 2023, ka shënuar rritje prej 4.58%, në numrin e të punësuarve 11.38%, dhe rritje në qarkullim vjetor prej 11.18%, krahasuar me vitin 2022.

Spektori C- Industria përpunuese, në normën e punësimit sipas aktivitetit ekonomik merr pjesë me 11.1%.

Spektori i prodhimit, bazuar në potencialin që ka, mund të japë kontribut të rëndësishëm në tërë këta tregues por edhe në strukturën e përgjithshme ekonomike të vendit. Megjithatë, sektori i prodhimit po ofron ende mundësi relativisht të kufizuara punësimi, duke punësuar aktualisht rreth 11.09%, të fuqisë punëtore për vitin 2023, ndërsa viti 2022 me 10.62% nga 11% sa ishte në vitin 2021.

Tabela 6. Sektori C, numri i ndërmarrjeve, të punësuarve dhe qarkullimi, 2021-2023

Kodi	Industria Përpunuese	Numri i ndërmarrjeve			Numri i të punësuarve			Qarkullimi		
	Sektori-C	Viti 2021	Viti 2022	Viti 2023	Viti 2021	Viti 2022	Viti 2023	Viti 2021	Viti 2022	Viti 2023
10	Përpunimi i produkteve ushqimore	1462	1503	1535	9,902	10,931	12,360	472,344,066.98	490,162,510.96	561,085,852.31
11	Prodhimi i pijeve	102	102	94	2,221	2,151	2,327	215,310,255.20	156,508,456.41	196,667,417.27
12	Prodhimi i produkteve të duhanit	7	5	4	74	56	48	9,410,896.98	4,866,541.49	5,839,657.34
13	Prodhimi i tekstilit	173	179	200	809	938	1,151	21,739,125.04	28,675,745.45	31,186,657.96
14	Prodhimi i veshjeve	350	397	404	1,610	1,841	2,118	18,494,832.71	18,692,419.49	22,958,140.57
15	Prodhimi i lëkurës dhe produkteve prej lëkure	39	39	39	406	404	365	8,339,665.13	11,597,152.83	10,527,865.53
16	Prodhimi i drurit dhe i produkteve të drurit dhe të tapës	521	506	504	2,389	2,655	2,910	78,118,256.02	85,983,088.64	88,625,018.18
17	Prodhimi i letrës dhe produkteve prej letrës	102	111	120	646	628	827	39,551,211.65	43,321,984.42	50,665,776.87
18	Shtypja dhe riprodhimi i mediave të incizuara	180	174	179	962	1,072	1,235	41,332,339.78	31,049,794.57	33,840,325.42
19	Prodhimi i Koksit dhe produkteve të rafinuara të naftës	8	5	6	179	177	186	22,415,373.85	16,482,741.52	15,672,577.76
20	Prodhimi i produkteve kimike	126	123	139	946	1,006	1,127	55,338,301.05	45,075,279.29	51,600,390.37
21	Prodhimi i produkteve bazë farmaceutike dhe preparateve far	6	7	7	118	124	217	-	2,716,465.32	4,661,311.69
22	Prodhimi i produkteve të gomës dhe të plastikës	579	626	670	3,661	4,035	4,655	198,116,219.72	257,367,563.53	278,546,416.86
23	Prodhimi i produkteve minerale jo metalike	545	547	562	5,469	5,458	5,851	324,357,558.04	439,618,261.48	487,503,084.12
24	Prodhimi i Metaleve	128	122	124	794	875	955	79,981,380.12	102,686,591.35	111,455,645.52
25	Prodhimi i produkteve të fabrikua metalike	770	790	836	3,065	3,292	3,869	160,666,951.86	198,982,656.43	246,434,152.11
26	Prodhimi i kompjuterëve, produkteve elektronike dhe optike	28	27	29	80	97	131	3,681,731.95	-	5,072,127.09
27	Prodhimi i pajisjeve elektrike	44	39	44	261	263	306	19,947,005.06	21,635,183.03	23,538,225.43
28	Prodhimi i makinerisë dhe pajisjeve p.k.t.	38	34	38	274	289	324	10,932,204.35	9,029,384.12	8,680,562.01
29	Prodhimi i mjeteve motorike, rimorkio dhe gjysmë rimorkio	6	8	6	111	120	119	4,713,085.63	2,151,554.95	2,345,947.16
30	Prodhimi i mjeteve tjera të transportit	9	4	3	55	50	54	2,081,758.78	2,091,799.46	1,894,727.98
31	Prodhimi i mobileve	549	600	655	4,915	5,684	5,739	190,907,254.90	249,330,671.03	231,832,198.56
32	Prodhimi tjetër p.k.t.	106	110	129	430	549	644	16,536,703.69	21,287,159.64	24,259,084.38
33	Riparimi dhe instalimi i makinerive dhe pajisjeve	106	104	117	181	192	250	5,353,314.37	4,042,196.70	4,533,136.45
	Gjithsejtë	5,984	6,162	6,444	39,558	42,887	47,768	2,003,697,898.65	2,243,355,202.11	2,499,426,298.94

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, përpunuar nga DI/DPI


Bazuar në të dhënat e prezantuara në tabelën nr.6 sa i përket Sektorit-C, rritjen më të lartë të numrit të ndërmarrjeve e kemi në vitin 2023 me 6,444 ose 282 ndërmarrje më shumë krahasuar me vitin 2022. Rritje është shënuar edhe në punësim për 4,881 punëtor më shumë se në vitin 2022. Qarkullimi vjetor në vitin 2023, ka shënuar rritje për 11.4%, krahasuar me vitin 2022. Sipas këtyre të dhënave të analizuara në tri vitet e fundit 2021-2023, vërehet se ka tendencë rritjeje që është sinjal pozitiv drejt zhvillimit ekonomik.

Kontributi i nën sektorëve në punësimin e përgjithshëm të Sektorit-C,

Kontributi i Sektorit të prodhimit/përpunimit në punësimin e përgjithshëm në Kosovë për vitin 2023 është 11.1%.

Punësimi sipas nën sektorëve paraqet kontributin e secilit nën sektor në krijimin e vendeve të punës në kuadër të Sektorit-C, (sektori prodhues/përpunues), i paraqitur si më poshtë.

Figura 8. Kontributi i nën sektorëve në punësimin e Sektorit-C, në % për vitin 2023



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, përpunuar nga DI/DPI


Bazuar nga të dhënat e paraqitura në figurën nr. 8, kontributin më të lartë në punësim të sektorit prodhues/përpunues në Kosovë, e krijon nën sektori “Përpunimi i produkteve ushqimore” me rreth 26%, i ndjekur nga nën sektori “Prodherimi i produkteve minerale jo metalike” me rreth 12.25%, ndërsa i treti me kontribut në punësim radhitet nën sektori “Prodherimi i mobilie” me rreth 12.01%, dhe nën sektori “prodherimi i gomës dhe plastikes” me rreth 9.75%, të kontributit në punësimin e përgjithshëm të Sektorit – C. Të gjithë nën sektorët tjerë kontribuojnë në më pak se 10% e punësimit.

Gratë të punësuar në Sektorin-C

Kosova kishte shkallën më të ulët të pjesëmarrjes së grave në prodhimtari në vend, duke pas parasysh disa barriera si p.sh mos respektimi i kontratave të punës që karakterizohet ende nga shkalla e lartë e informalitetit dhe kushteve të pa pafavorshme të punës, sidomos punësimit të grave dhe të rinjve.

Deri me tani pjesëmarrja e punësimit të grave sipas të dhënave për vitet 2015-2023, është tejet e ulët sidomos në sektorin e prodhimit, trendi i ngadalshëm i punësimit të grave është përcjell vazhdimisht në vend, por me të dhëna premtuese të rritjes pozitive në punësim sipas gjinisë.

Figura 9: Punësimi gjithëpërfshirës në % (sipas gjinisë), në Kosovë 2015-2023



Burimi: ASK (përpunuar nga DI/DPI-së)

Bazuar në të dhënat e publikuara nga figura nr. 9 vërejmë se punësimi i grave në Kosovë në punësimin e përgjithshëm në vitin 2015 ishte 22.5%, ndërsa në vitin 2023 kishte shënuar rritje në rreth 28%, që paraqet rritje për 6%, ndërsa pjesëmarrja e punësimit të grave në totalin e punësimit në prodhim, ishte e ulët në Kosovë, në vitin 2015 me 10.22% dhe në vitin 2023 rreth 21%, që paraqet rritje në favor të punësimit me 10.9%.

Elasticiteti i punësimit

Ndryshimet globale edhe në tregjet e punës kanë krijuar mundësi të mëdha, që edhe ekonomitë e zhvilluara të kenë vështirësi në ruajtjen e elasticitetit të punësimit. Ndryshimet mund të vijnë edhe nga faktorë të shumtë, qoftë nga krizat që mund të jenë të pa parashikuara, siç ishte me pandeminë Covid-19, por edhe si pasojë e transformimit digjital. Elasticiteti mund të ketë ndryshime në raport me produktivitetin në punë varësisht se nga do të jetë e orientuar norma vjetore e rritjes, qoftë nga punësimi apo nga produktiviteti.

Tabela 7: Elasticiteti i punësimit krahasuar me vendet tjera për vitet 2015-2022

Vendet	Norma vjetore e rritjes së punësimit	Norma vjetore e rritjes së VSHP	EE	Klasifikimi
Shqipëria	4.1%	5.2%	0.7	Drejtuar nga produktiviteti
Bosnja dhe Hercegovina	2.9%	3.7%	0.7	Drejtuar nga produktiviteti
Mali i Zi	2.8%	1.6%	1.7	Drejtuar nga punësimi
Maqedonia e Veriut	0.3%	0.9%	0.3	Drejtuar nga produktiviteti
Serbia	4.1%	2.1%	2.0	Drejtuar nga punësimi
Kosova	3.9%	4.0%	1.92	Drejtuar nga produktiviteti
BP6	3.3%	2.6%	1.2	Drejtuar nga punësimi

Burimi: VShP - WDI; Punësimi në Prodhim, UNIDO, ASK (përpunuar nga stafi i DI/DPI-së)

Analiza tregon se ndërmjet viteve 2015-2022, sektori i prodhimit në Kosovë u rrit çdo vit me një normë të përbërë prej 4.0%, ndërsa punësimi në industri u rrit me 3.9%, gjatë të njëjtës periudhë. Sipas këtyre të dhënave vlerësohet se norma e rritjes në Kosovë është e drejtuar (udhëhequr) nga produktiviteti, gjë që vërehet më shumë interesim të investohet në digjitalizim dhe teknologji të avancuar. Nëse e vështrojmë tabelën në përgjithësi, del se në vendet e Ballkanit Perëndimor e kemi një situatë të njëjtë, gjysma e vendeve e ka normën e rritjes të drejtuar nga punësimit, ndërsa gjysma tjetër nga produktiviteti në punë.

Pagat në Prodhim

Rritja e produktivitetit të punës përkthehet pozitivisht në rritje të pagave në prodhim. Duke u referuar të dhënave nga tabela nr.8, norma e rritjes së produktivitetit në Kosovë në vitin 2021 është 5.9% dhe norma e rritjes së pagave me 13.8%, që flet për trend pozitiv të rritjes në normë vjetore të produktivitetit dhe reflektim rritjeje edhe në paga. Vlen të theksohet që në këta tregues të analizuar, Kosova qëndron krahas vendeve të BP6, bile në disa prej treguesve qëndron më mirë. Ndërsa, në të gjitha vendet krahasuese të BP6, norma e rritjes së pagave ishte pozitive edhe pse nuk kanë shënuar normë negative vjetore të produktivitetit në punë.

Tabela 8: Pagat për vitin 2021


Vendet	Norma e rritjes së pagave	Norma e rritjes së produktivitetit
Shqipëria	14.05%	4.2%
Bosnja dhe Hercegovina	8.38%	2.33%
Mali i Zi	5.75%	0.87%
Maqedonia e Veriut	6.04%	4.54%
Serbia	10.20%	0.20%
Kosova	13.84%	5.93%

Burimi: WDI, UNIDO, ASK (përpunuar nga stafi i DI/DPI-së)

Intensiteti relativ i pagave në industrializim

Ndërmjet viteve 2015 dhe 2021, pagat e sektorit të prodhimit u rritën mesatarisht me 11%. Rritja e fitimeve për punëtorët konfirmohet edhe nga studimi i intensitetit relativ të pagës, i matur si përqindje e pagave të prodhimit si pjesë e VShP-së. Ky tregues mat pjesën e VShP-së që u shkon punëtorëve të sektorit të prodhimit në formë të pagave. Figura 10, më poshtë tregon se intensiteti relativ i pagave në Kosovë është rritur nga 21% (2015) në 35% (2021). Shkurtimisht, me një sektor prodhimi në rritje, fatura totale e pagave të prodhimit është rritur. Megjithatë, ajo rezulton ende në intensitetin më të ulët të pagave relative në rajon. Të gjitha vendet krahasuese zënë mbi 40% të peshës së pagave në VShP.

Figura 10. Intensiteti relativ i pagave të industrisë




Burimi: Indikatorët e Shteteve WDI, UNIDO, ASK-së (përpunuar nga stafi i DI/DPI)

Totali i pagave në Sektorin-C, në raport me Vlerën e Shtuar në Prodhim (VShP)

Paraqet raportin në mes faturës së kostos totale të pagave për Sektorin-C, në korrelacion me vlerën e shtuar të prodhimit.

Në figurën 11, më poshtë janë paraqitur disa nga nën sektorët e Sektorit-C, ku shihet raporti në përqindje i VSHP-së me faturën e pagës totale për nën sektor.

Figura 11: Fatura e pagave në raport me Vlerën e Shtuar në Prodhim, VSHP shprehur në %



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (përpunuar nga stafi i DI/DPI)


ANALIZA MJEDISORE

Efiçienca e energjisë në sektorin e prodhimit

Kosova në vitin 2022, vlerën e efiçienecës së energjisë në prodhim e kishte 4.07 milion euro për njësi të ktoe (kilo ton për njësi ekuivalente të naftës), që është më e lartë se mesatarja e vendeve të BP6 me 3.71 milion euro/ktoe. Vlerën më të lartë të efiçienecës së energjisë e kishte BeH me 5.22 milion euro/ktoe, ndërsa vlerën më të ulët e ka Mali i Zi dhe kishte vlerën më të ulët prej 1.06 milion euro/ktoe.

Në vitin 2013 efiçienca e energjisë ishte 2.61 milion euro/ njësi e ktoe, në vitin 2022 kemi rritje të efiçienecës për 56 %, në vlerën 4.07 milion euro për njësi të ktoe.

Figura 12: Efiçienca e energjisë në sektorin e prodhimit




Burimi: International Energy Agency (IEA) (përpunuar nga stafi i DI/DPI-së)

Intensiteti i energjisë në prodhim

Intensiteti energjetik në Kosovë (sasia e energjisë së përdorur për të prodhuar një njësi të BPV), është përmirësuar ndjeshëm me kalimin e kohës, nga viti 2013 në vitin 2022 kemi rënie të intensitetit të energjisë për 20%, mirëpo është më i lartë se mesatarja e vendeve të Ballkanit Perëndimor BP6, pas Bosnjës dhe Hercegovinës.


Figura 13: Intesiteti i energjisë



Burimi: International Energy Agency (IEA)

Emetimet e CO2

Emetimet e CO₂, të Kosovës në sektorin e prodhimit për vitin 2021 janë, 0.747 Mt (mil/ton) CO₂, në vlerën e shtuar në prodhim të (VSHP-së), 1,025.9 milion euro, apo 0.73 kg CO₂, për milion EUR në VSHP), nga viti 2015 në vitin 2021 ka rënie për 16% edhe pse rënia është mbi mesataren e BP6. Emetimin më të ulët në vitin 2021 e ka Serbia prej 0.39 kg CO₂/mil Euro dhe Bosnja e Hercegovina me 0.59 kg CO₂ për milion euro të VSHP-së, ndërsa Shqipëria ka emetimin më të lartë prej 1.29 kg CO₂/mil. euro dhe Mali i Zi emeton 0.93kg CO₂/mil euro në raport me VSHP-në.


Figura 14: Emetimet e CO₂, për milion euro në Vlerën e Shtuar të Prodhimit

Burimi: International Energy Agency (IEA) (përpunuar nga stafi i DI/DPI-së)

Intensiteti i CO2 për vlerën e shtuar në Prodhim

Intensitetin CO2 në konsumin e energjisë në Kosovë në vitin 2021 ishte 54.4 g/MJ, me rritje për 10% nga viti 2015 që ishte 49.9 g/MJ. Mesatarja e vendeve të Ballkanit Perëndimor BP6 ishte 50.05 g/MJ, intensitetin më të lart të CO2, në konsumin e energjisë e ka Shqipëria 64.5 të CO2 g/MJ. Intensitetin më të ulët të CO2 në konsumin e energjisë e ka Serbia me 31.4 g/MJ CO2.

Figura 15: Intensiteti i CO2 në konsumin e energjisë për industrinë prodhuese




Burimi: International Energy Agency (IEA) (përpunuar nga stafi i DI/DPI-së)

Industria e gjelbër dhe qarkore

Vlera e shtuar bruto në sektorët që lidhen me ekonominë qarkore (% e BPV - se totale), në vitin 2020 ishte 0.80%, ndërsa në vitin 2021 ishte 0.828%.

Figura 16: Mbeturinat e trajtuara (ricikluara) sipas llojit



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (përpunuar nga stafi i DI/DPI)

Sasia e mbeturinave të trajtuara (ricikluara) sipas viteve dhe llojit

Sasia e mbeturinave të trajtuara ndër vite: 2019 ishte 5,773 ton, në vitin 2020 ishte 3,882 ton, në vitin 2021 ishte 23,328 ton dhe në vitin 2022 ishte 24,904 ton.

Sasia e mbeturinave të trajtuara sipas llojit e shprehur në përqindje për vitin 2022 ishte: Mbeturinat nga letra dhe kartoni (45%); Mbeturinat nga plastika (35%); Mbeturinat nga metalet (15%).

Sasia e mbeturinave të trajtuara, sipas llojit, të shprehura në përqindje për vitin 2021 ishin si vijon: Metalet (14%); mbeturinat nga plastika (31%); mbeturinat e letrës dhe kartonit (51%).

Sasia e mbeturinave të trajtuara, sipas llojit e të shprehura në përqindje për vitin 2020 ishin si vijon: Metalet (26.4%); mbeturinat nga plastika (47.2%); mbeturinat e letrës dhe kartonit (6.2%).

Sasia e mbeturinave të trajtuara, sipas llojit e të shprehura në përqindje për vitin 2019 ishin si vijon: Metalet (54%), mbeturinat nga plastika (22%), mbeturinat spitalore (19%), mbeturinat e letrës dhe kartonit (5%). Nëse i analizojmë këto të dhëna nëpër vite mund të themi se mbeturinat sipas llojeve të cekura kanë shënuar trend varirues (oscilues), nëpër vite, por më rëndësi është që bizneset të cilat kanë mbetje të tilla të zhvillojnë kapacitetet e riciklimit, që janë në të mirë të ambientit por edhe të zhvillimit të industrisë në vend.

Përmbledhje e indikatorëve

- Kosova paraqet performancë më të ulët ekonomike të përgjithshme në BPV / kokë banori prej 5,038 € për vitin 2023, që do të thotë se është nën mesataren e BP6 sa është 6,145 €;
- Shkalla e rritjes së BPV-së/kokë banori e Kosovës ishte prej 5.9% gjatë periudhës 2011-2023, ku tejkaloi rajonin me (0.8%), me përjashtim të Bosnjës e Hercegovinës e cila kishte rritje për 6.1%, ndërsa mesatarja e BP6 ishte 5.4%;
- Kosova kishte 647.3€/kokë banori, mbi mesataren e BP6 që ishte prej 588.82 €/kokë banori, më ulët se Serbia dhe Bosnjën e Hercegovinën;
- Industria përpunuese (Sektori C) në BPV merr pjesë me 12.8%;
- Në vitin 2023, industrializimi i Kosovës, i matur me pjesëmarrjen e VShP në BPV, është (12.77%) e tejkalon mesataren e BP6 (10.25%), me përjashtim të Bosnjës e Hercegovinës me (13.05%);
- Sektori C- Industria përpunuese, në normën e punësimit sipas aktivitetit ekonomik merr pjesë me 11.1%;
- IHD-të hyrëse në sektorin e prodhimit, në vitin 2023 ishin 13.2 milion euro;
- Pjesëmarrja IHD-ve të prodhimit në totalin e IHD-ve për vitin 2023 është 1.56%;
- Norma efektive e interesit në sektorin e industrisë përpunuese për vitin 2023 është 6.8%;
- Rreth 60% e eksportit realizohet në 5 shtete: Maqedoni të Veriut, Shqipëri, SHBA, Gjermani dhe Zvicër;
- Rreth 60% e importit, realizohet nga 7 shtete: Turqi, Gjermani, Kinë, Greqi, Shqipëri, Maqedoni të Veriut dhe Itali;
- Pjesëmarrja e punësimit të grave në prodhim është 21%;
- Emetimet e CO₂, të Kosovës në sektorin e prodhimit për vitin 2021 janë, 0.747 Mt (mil/ton) CO₂.

Konkluzionet

- Kosova edhe pse ka treguar rritje të BPV-së për kokë banori dhe është rritur me një rritje më të shpejt se vendet e rajonit, ende është nën mesataren e BP6;
- Sektori i prodhimit, mbetet i qëndrueshëm në pjesëmarrje në BPV, megjithatë krahasuar me vitin 2022, ka shënuar rënie dhe vazhdon të mbajë vendin e dytë pas tregtisë edhe pse kontribuon në rritjen e Vlerës së Shtuar të Prodhimit në vend si dhe në rritjen e numrit të punësuarve;
- Industrializimi i Kosovës, i matur me pjesëmarrjen e VSHP-së në BPV, tregon një qëndrueshmëri ndër vite dhe është më i lartë se Mali i Zi, Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut;
- Struktura e përbërjes ekonomike të Kosovës, bazuar në pjesëmarrjen e VShP-së në BPV, vazhdon të dominohet nga sektori i shërbimeve, me një mesatare prej 45%, ndërsa sektori i prodhimit merr pjesë me një mesatare prej 13% të VSHP në BPV;
- Investimet e Huaja Direkte janë një nga faktorët që ndikojnë në rritjen Ekonomike. Por në Kosovë IHD-të janë ende të orientuara në sektorin e patundshmërive dhe ndërtimit e që kanë më pak efekt të përhapjes/shtrirjes (spillover effect);
- Normat e interesit bankar janë ende të larta për industrinë përpunuese me 6.8%, gjë që u pamundësojnë bizneseve zgjerimin e kapaciteteve të tyre në prodhim;
- Industria prodhuese/përpunuese ka potencial të lartë në uljen e deficitit tregtar, duke marr parasysh pjesëmarrjen në eksportin e përgjithshëm me 84%, ku mbulueshmëria e importit me eksport është me vetëm 14%;
- Eksportet e produkteve të industrisë prodhuese/përpunuese janë nga vendet ku është e përqendruar diaspora, gjë që e pasqyron diversifikimin e kufizuar të eksporteve në tregun e përgjithshëm;
- Importet e industrisë përpunuese vazhdojnë të jenë të larta, për arsye se ekonomia e Kosovës nuk po arrin të intensifikoj sigurimin e lëndëve të para nga burimet vendore që do të kontribuonin në uljen e importit;
- Sektori i industrisë përpunuese ka potencial për punësim më të lartë të grave, por pjesëmarrja e grave në punësim të ky sektor vazhdon të jetë e ulët, në krahasim me vendet e BP6;
- Vlerësuar produktivitetin dhe pagat, Kosova dhe vendet tjera të BP6, kanë shënuar rritje në paga. Megjithatë, Kosova ka shënuar rritje në normën e produktivitetit dhe normën e pagave;
- Efiçienca e energjisë në industrinë prodhuese/përpunuese në Kosovë vazhdon të ketë rritje ndër vite dhe qëndron mbi mesataren e vendeve të BP6 dhe më mirë se Shqipëria dhe Mali i Zi;
- Emetimet e CO2 në industrinë prodhuese/përpunuese në Kosovë vazhdojnë të kenë rënie nderë vite, mirëpo qëndron mbi mesataren e vendeve të BP6 dhe ka më pak emetim të CO2 se Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut.

Referencat

- Agjencia e Statistikave të Kosovës / Anketa e Fuqisë Punëtore
- Agjencia e Statistikave të Kosovës, Vjetari Statistikor
- Banka Qendrore e Kosovës, Raporti vjetor 2023
- Banka Qendrore e Kosovës, IHD sektoreve ekonomik, [https://bqk-kos.org/statistikat/serite-kohore/qasur më 09.07.2024](https://bqk-kos.org/statistikat/serite-kohore/qasur_më_09.07.2024)
- Banka Qendrore e Kosovës, IHD sipas vendeve, [https://bqk-kos.org/statistikat/serite-kohore/qasur më 10.07.2024](https://bqk-kos.org/statistikat/serite-kohore/qasur_më_10.07.2024)
- Exports by enterprise size class - OECD iLibrary, https://www.oecd-ilibrary.org/docserver/entrepreneur_aag-2013-11-en.pdf
- International Energy Agency (IEA)
- United Nations Industrial Development Organization (UNIDO), <https://www.unido.org/search?keys=wages+kosovo>
- World Development Indicators (WDI), <https://databank.worldbank.org/source/world-development-indicators>
- World Integrated Trade Solution (WITS), <https://wits.worldbank.org/>

Ky raport është përgatitur nga Departamenti i Industrisë/Divizioni për Politika Industriale.

Kontakti:

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë

Departamenti i Industrisë, Divizioni për Politika Industriale

Rruga "Arbënor e Astrit Dehari" nr. 21, Lagja e Spitalit

10000 Prishtinë/Republika e Kosovës

Tel: +383 38 200 36 545; 36 547

<https://mint.rks-gov.net/>